

37

Jpa fpi - 25

BASHKIA GJIROKASTER

KONTRATE PER PUNE PUBLIKE

**OBJEKTI KONTRATES; "RIKONSTRUKSION I SHKOLLES
SE MESME SIRI SHAPLLO" GJIROKASTER.**

PALET KONTRAKTUESE:

INVESTITORI; "BASHKIA GJIROKASTER"

KONTRAKTUESI; J.V. "B-93" SH.P.K dhe "BE-IS" sh.p.k

VITI 2014

Prot. 3236

07.11.2014

FORMULARI I KONTRATËS

Titulli i Kontratës: **"Rikonstruksion i shkolles se mesme Siri Shaplo"**
Gjirokaster

Kjo Kontratë është lidhur më **07.11.2014** midis **Bashkise Gjirokaster** tani e tutje të referuar si **"Autoriteti Kontraktor"** përfaqësuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor **Z. Flamur BIME** Kryetar i Bashkise dhe **bashkimit te operatoreve ekonomike "B-93" SHPK me NIPT J62903508R dhe "BE-IS" SHPK me NIPT K71412003A**, me kontrate bashkepunimi Nr 6661 rep. Nr 2844 kol, date 15.10.2014 dhe prokure te posacme NR 6662 rep. Nr 2845 Kol, date 15.10.2014 per shoqerine **"B-93" sh.p.k** perfaqesuar nga **z. Shpetim LIÇAJ** si perfaqesues ligjor i shoqerise **"B-93" Sh.p.k** dhe **Z.Hamza ISLAMAJ** perfaqesues i shoqerise **"BE-IS" sh.p.k** tani e tutje te quajtur si **"Kontraktuesi"**.

Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor paraqet një kërkesë për Realizimin e Punëve, duke i'u referuar Prokurimit me objekt: **"Rikonstruksion i shkolles se mesme Siri Shaplo" Gjirokaster**

Menjëherë pasi Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë 16.10.2014 bie dakord të realizojë Punët, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë Formular Kontrate
- Formularin për Ofertë, të paraqitur nga Ofertuesi
- Kërkesat e pergjithshme te Pranimit/Kualifikimit
- Programin Përfundimtar dhe Specifikimet Teknike
- Preventivin e Kostove
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Kushtet e Veçanta të Kontratës
- Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor
- Formularin e Sigurimit të Kontratës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate.

Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor pranon Ofertën nga Kontraktori, në një shumë prej **27 740 901** (njetzet e shtate milione e shtateqind e dyzet mije e nenteqind e nje) **leke pa t.v.sh** dhe me vlere te pergjithshme **33 045 881** (tridhjetë e tre milione e dyzet e pese mije e teteqind e tetedhjetë e nje) **leke me t.v.sh** për realizimin e Punëve;




Palët bien dakort si më poshtë:

1. Kontraktuesi duhet të paraqesë një Sigurim Kontrate në shumën prej: **3 304 588 (tre milione e treqind e kater mije e peseqind e tetedhete e tete)leke** në formën e Kompani Sigurimesh, ose garanci bankare, në ose përpara datës së shprehur në Njoftimin e Fituesit.
2. Kontraktuesi është i detyruar të kryejë Punët për Autoritetin Kontraktor, siç kërkohet në këtë Kontratë.
3. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë për Punët, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.
4. Në këtë Formular Kontrate, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet atyre në Kushtet e Kontratës.
5. Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.

Sot, më datë **07.11.2014** palët bien dakort për nënshkrimin e këtij Formulari Kontrate.

**AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA GJIROKASTER**



Adresa ; Sheshi i Cercizit Gjirokastrer

Nr tel : 084 26 35 00

**KONTRAKTUESI
JV "B-93" sh.p.k & "BE-IS" sh.p.k**



Per "BE-IS" sh.p.k

Z. Hamza ISLAMAJ



Juristi

Semi Golemi

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA E QYTETIT

GJIROKASTER

Nr 3236 .Prot

Date 07.11.2014

KONTRATE PER PUNE PUBLIKE

Kontrate Publike per kryerjen e punimeve ne objektin;
" Rikonstruksion i shkolles se mesme Siri Shaplo" Gjirokaster"

E lidhur sot me daten 07.11.2014 ne Bashkine Gjirokaster , mbeshtetur ne vullnetin e lire te paleve , bazuar ne dispozitat e Kodit Civil , neni 850 e vijim dhe Ligjit nr 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar sipas kushteve te meposhtme:

KREU I : KUSHTET E VECANTA (PUNET)

Kushtet e vecanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Ne rast se do të ndodhë ndonjë konflikt, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë mbi ato të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 1 ; Perkufizime

Autoriteti Kontraktor eshte **Bashkia Gjirokaster**, përfaqësuar nga **Z.FLAMUR BIME** kryetar i Bashkise njohur me poshte si "**AUTORITETI KONTRAKTOR**":

Kontraktuesi eshte **bashkimi i operatoreve ekonomike "B-93" SHPK me NIPT J62903508R dhe "BE-IS" SHPK me NIPT K71412003A** , me kontrate bashkepunimi Nr 6661 rep. Nr 2844 kol, date 15.10.2014 dhe prokure te posacme NR 6662 rep. Nr 2845 Kol, date 15.10.2014 per shoqerine **"B-93 "sh.p.k** perfaqesuar nga **z. Shpetim LIÇAJ** si perfaqesues ligjor i shoqerise "B-93 " Sh.p.k dhe **Z.Hamza ISLAMAJ** perfaqesues i shoqerise **"BE-IS" sh.p.k** tani e tutje te quajtur si **"Kontraktuesi** te cilet perfaqesojne kete bashkim operatoresh per detyrimet e kesaj kontrate.

Neni 2 : Objekti



Autoriteti Kontraktor **Bashkia Gjirokaster** mbi bazen e dokumentacionit qe disponon pas zhvillimit te procedures se prokurimit me daten **16.10.2014** dhe shpalljes se fituesit per kete procedure, i beson Kontraktuesit kryerjen e punimeve per objektin "**Rikonstruksion i shkolles se mesme Siri Shaplo**" **Gjirokaster** ne baze dhe per zbatim te projektit dhe preventivit te hartuar per kete objekt kundrejt pagimit te vleres se kontrates.

Neni 3 : Kantieri

Kantieri i punimeve do te jete **shkolla e mesme Siri Shaplo** Gjirokaster

Neni 4 : Vlera e Kontrates

Vlera totale e kontrates eshte **33 045 881** (tridhjetë e tre milione e dyzet e pese mije e teteqind e tetedhjetë e nje)**leke me t.v.sh** .
Financimi per vitin 2014 eshte **18 163 567** (tetembedhjetë milion e njeqinde e gjashtedhjetë e tre mije e peseqind e gjashtedhjetë e shtate)**leke me t.v.sh**.

Neni 5 : Data e fillimit dhe perfundimit te punimeve

Kontraktuesit di t'i jepet leja per t'u futur ne kantier menjehere me lidhjen e kontrates .

Kontraktuesi do te filloje punimet ne daten **07.11. 2014**

Afati i perfundimit te punimeve eshte date **06.01. 2015**

kjo sipas afatit te percaktuar ne dokumentat e tenderit dhe te pranuar nga Kontraktuesi.

Per cdo ndryshim te afatit te punimeve duhet te bien dakord te dy palet me shkrim.

Kontraktuesi do te beje zbatimin e punimeve brenda afatit te punimeve te caktuar ne kontrate duke organizuar punen ne perputhje me VKM nr 42 date 16.01.2008 kreu III .

Neni 6 : Nderprerja e punimeve

Kontraktuesi eshte i detyruar te beje nderprerjen e punimeve dhe me pas rifillimin e tyre kur urdherohet nga Autoriteti Kontraktor.

Mbetet e drejte e firmes ndertuese te kerkoje zgjatjen e afatit per perfundimin e punimeve per sa kohe qe punimet jane nderprere nga Autoritetit Kontraktor.

Neni 7 : Sigurimi i Kontrates

Garancia e kontrates e paraqitur nga sipermarresi para lidhjes se kontrates , sipas modelit perkates te dhene ne dokumentat e tenderit, kap vleren 10% te vleres se kontrates **3 304 588** (tre milione e treqind e kater mije e peseqind e tetedhjetë e tete)**leke** .Kjo shume do



te garantoje Autoritetin Kontraktor per permbushjen e detyrimeve Kontraktuale nga sipermarresi.

Neni 8 : Garancia e Punimeve

Kontraktuesi eshte i detyruar te garantoje cilesine e mire te punimeve dhe ne perputhje me te gjitha kushte teknike te percaktuar me pare ne preventiv dhe ne dokumentat e tjera ne funksion te tij. Kontraktuesi garanton Autoritetin Kontraktor per defektet e punimeve qe ai do te realizoje per nje periudhe 12 mujore duke filluar nga dita e marrjes ne dorezim te punimeve. Shuma e mbajtur per efekt te garanacise se punimeve do te jete 5% e vleres se kontrates dhe nuk do te clirohet deri ne perfundimin e periudhes se garancise (**12 muaj**). Per defektet e mundshme ne punimet e kryera (te vena re gjate periudhes 12 mujore) Autoriteti Kontraktor garantohet nepermjet garancise per defektet si me siper.

Neni 9: Siguracioni.

Nga data e hyrjes ne kantier deri ne Afatin e Realizimit se Plote, Kontraktori duhet te siguroje objektin dhe mban pergjegjesi sipas legjislacionit ne fuqi per humbje ose demtim te Punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose demtim te kantierit ose pronave te tjera ne kantier dhe demtimet personale ose vdekjet e paleve te treta.

Neni 10 : Mbikeqyresi i Punimeve

Autoriteti Kontraktor deklarone se dispozitat qe kane lidhje me realizimin e objektit dhe administrimin e kesaj kontrate i rezervohen titullarit ose perfaqesuesve te tij .Autoriteti Kontraktor deklarone se ne baze te ligjeve ne fuqi **Mbikeqyres i punimeve do te jete Ing.Antoneta Çako MK 1693 dhe Ing.Anastas Sotiri me nr licence MK 288/1 .**

Kontraktuesi duhet t'i neneshtohet te gjitha dispozitave te mbikeqyresit te punimeve i cili ka te drejten e verifikimit te kryerjes se punimeve si gjate vazhdimit dhe gjate perfundimit te tyre.Mbikeqyresi i punimeve do te njoftoje sipermarresin lidhur me çdo difekt para mbarimit te garancise te periudhes se garancise per difektet . Periudha e garancise se difekteve do te shtyhet deri sa te korrigojohen difektet. Në qofte se sipermarresi nuk e korrigjon difektin brenda afatit te percaktuar ne njoftimin e Mbikeqyresit te punimeve ky i fundit do te vleresoje koston e korrigjimit te difektit dhe sipermarresi do te paguaje këtë shume ose Autoriteti Kontraktor do ti mbaje këto shuma duke i zbritur nga pagesat pasardhese, ose sigurimi i kontrates.Perpara fillimit te punimeve sipermarresi do ti paraqese per miratim Mbikeqyresit te punimeve një program ne të cilen tregohet menyra e kryerjes se punimeve , grafiku i punimeve Sipermarresi do të plotesoje programin sipas grafikut të parashikuar

Neni 11 : Inspektimet dhe testimet , marrja ne dorezim e punimeve

Inspektimet dhe testimet para vertetimit te Mbarimit te Puneve do te perfshijne te gjithë kontrollet, inspektimet, testimet qe do të kryehen



Mbikeqyresi i punimeve gjate zbatimit te punimeve , ne zbatim te dispozitave ne fuqi.

Autoriteti Kontraktor mund te beje kontroll te gjithë dokumentacionit qe krijohet ne funksion te kontrates dhe te beje sondazhe ne lidhje me vertetesine e punimeve .Per cdo parregullsi qe ai evidenton i gjithë demi i vihet ne ngarkim Kontraktuesit.

Autoriteti Kontraktor do te kryeje verifikimin perfundimtar te punimeve brenda 5 (pese) ditesh nga data e perfundimit te punimeve. Marrja ne dorezim do te behet nga ana e Autoritetit Kontraktor pas perfundimit te kolaudimit te punimeve.

Neni 12 : Lloji i Kontrates

Kontrata është me cmime njesie të bazuar në cmimet e njesise të shprehura në preventivin ne njesi.

Neni 13 : Ndryshimet e punimeve

Kontraktuesi nuk ka te drejte te beje ndryshime ne preventivin e paraqitur ne tender te aprovuar per punimet , pervec se atyre te autorizuara me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

Cdo ndryshim ne sasi do te behet ne baze te nje propozimi teknik te miratuar nga mbikeqyresi i punimeve dhe nga ana e Autoritetit Kontraktor si dhe ne baze te llogaritjes perkatese te mbeshtetur ne cmimet njesi per cdo ze pune te parashikuar ne preventiv.

Palet jane te detyruara qe per rastet te paparashikuara ne projekt te zbatojne kerkesat e neneve 860, 862 te Kodit Civil si dhe nenet 35,36/1,2,3,4 te kushteve te pergjithshme te kontrates.

Cmimet jashte kontrates caktohen sipas analizave teknike ne fuqi,me vleren ekonomike me te mire.

Neni 14 : Grafiku dhe menyra e pageses.

Pagesa do te behet sipas vleres se situacioneve te dorezuara ,duke zbritur paraprakisht garancine e defekteve.

Mund te perpilohen dhe situacione pjesore (per nje pjese te punimeve te kryera).

Kontraktuesi do ti paraqese Mbikeqyresit të punimeve situacionet pjesore për punimet e kryera , duke zbritur pagesat e situacioneve të meparshme , garancine e difekteve në vleren 5 % të vleres së situacionit pjesor .

Mbikeqyresi i punimeve do të firmose situacionin pasi te kontrolloje punen e kryer ne fakt nga sipermarresi dhe do të vertetoje shumen që do t'i paguhet sipermarresit .

Situacionet pjesore te hartohen ne lloje, zera , sasi, cmime vlere,sipas kontrates dhe ndryshimeve te urdheruara nga investitori.



Zerat, sasite, cmimet jashte kontrates dhe perdorimi i fondit rezerve ne situacionin perfundimtar justifikohen me dokumentacionin perkates. (Udhezimi Nr2 dt 13.05.2005KM)

Vlera e punimeve të kryera do të percaktohet nga Mbikeqyresi i punimeve dhe do të perfshije vleren e volumeve të zerave të punimeve të perfunduara dhe të dhena ne preventiv.

Sipermarresi mbas perfundimit të punimeve i paraqet mbikeqyresit të punimeve dokumentacionin dhe llogaritjet perfundimtare të punimeve të cilat Mbikeqyresi i punimeve mbasi ben verifikimin nga ana e tij së bashku me një relacion ia paraqet, Investitorit.

Pagesa nga ana e investitorit për punimet e kryera do t'i bëhet kontraktuesit me urdher xhirimi në llogarine rrjedhese **te BE-IS sh.p.k ne Raiffeisen Bank me Nr 0100998547 dhe te shoqerise B-93 sh.p.k ne banken Kombetare Tregtare me Nr 411055307**

Pagesa per Punet e kryera duhet bere brenda 30 diteve nga data qe kontraktuesi paraqet nje dokument (situacionin) qe deklaron se objektivi per pagesen eshte arritur.
Kontraktuesi nuk do te marre pagese paraprake.

Neni 14 : Detyrimet e Kontraktuesit

Kontraktuesi (sipermarresi) , me qellim qe te kryeje punen ne kushte e parashikuara ne kete kontrate eshte i detyruar:

- Te perfundoje objektin sipas volumeve, zerave te pecaktuar ne preventiv si dhe ndryshimeve te miratuara , brenda te gjitha kushteve teknike dhe konform kerkesave te Autoritetit Kontraktor ne dokumentat e tenderit.
- Te interesohet ne kujdesin dhe shpenzimet e tij te beje furinizmin me materiale dhe mjete ne gjendje te mire dhe ne masen e nevojshme per nje zhvillim korrekt dhe te shpejte te punimeve
- Te marre persiper te gjitha pergjegjesit qe rrjedhin nga sigurimi teknik ne pune.

Neni 15 : Detyrimet e Autoritetit Kontraktor

Autoriteti Kontraktor ka detyrim

- Sigurimin e skicave dhe mbikeqyrjen e punimeve
- Caktimi i mbikeqyresit te punimeve
- Marrja ne dorezim e punimeve kur keto te jene kryer sipas kushteve teknike, skicave dhe preventivit te hartuar per kete qellim
- Pagesa e situacioneve.

Neni 16 : Demet



Kontraktuesi merr persiper pergjegjesine e ruajtjes se punimeve te kryere deri ne castin e dorezimit perfundimtar te punimeve. Demet e mundshme ne punimet e perfunduara ose ne perfundim e siper i ngarkohen firmes sipermarrese , kur per to nuk eshte shkak forca madhore. Kontraktuesi do te mbaje pergjegjesi per zbatimin e punimeve sipas kushteve te percaktuar ne kete kontrate dhe ne dokumentat e tenderit perkates.

Neni 17: Dëmet e Likuidueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve

Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

Neni 18 : Komunikimi midis paleve

Komunikimi midis paleve duhet të bëhet vetem me shkrim . Njoftimi bëhet efektiv vetem pasi të dorezohet

Neni 19 : Gjuha e kontrates.

Gjuha e kontrates eshte shqip.

Neni 20 : Zgjidhja e mosmarreshjeve

Ne rast mosmarreshjesh , kur keto nuk zgjidhen me mirekuptim nga palet , kompetence per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Gjirokaster.

**AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA GJIROKASTER**

PERFAQESUAR NGA
KRYETARI

FLAMUR BIME

**KONTRAKTUESI
JV“ B-93 ” sh.p.k & “BE-IS ” sh.p.k**

PËRfaqësuar nga

PER "B-93" sh.p.k

Z. Shpetim GJAJ

Per "BE-IS" sh.p.k

Z. Hamza ISLAMAJ

Juristi

Semi Golemi



KREU II. KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS

Punët – Procedura e Hapur

Titulli i Kontratës: **Rikonstrukcion i shkolles se mesme Siri Shaplo”**
Gjirokaster

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.



- 2.4 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 "Cmim kontrate" do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 "Realizimi i punimeve" do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 "Defekt" do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 "Data e hyrjes" do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 "Data e fillimit" është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, "data e fillimit" do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhënia.
- 2.10 "Pajisje" do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 "Materiale" do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 "Objekt i kontratës" do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 "Palë(t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 "Drejtues projekti" do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 "Autoritet Kontraktor" do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kesaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kesaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 "Kantier" do të thotë vendi fizik i Punimeve.



- 2.17 "Raport i inspektimit të kantierit" do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 "Nënkontraktues" do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 "Kontraktor" do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 "Standarte Teknike" do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 "Ngritja e kantierit" do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 "Punime" do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikët e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.



4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e kofidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.


Neni 6: Prona Intelektuale

6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specififikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.



Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkepunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkepunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit



13/10/2019

27.2 Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

Neni 28: Çmimi i Kontratës

28.1 Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Neni 29: Kushtet e Pagesës

29.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhet siç specifikohet në kontratë.

29.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet më një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës dhe i përcaktuar në kontratë.

29.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori ka të drejtë të marrë pagesa periodike gjatë progresit të zbatimit të projektit. Grafiku i pagesave periodike do të parashikohet në KVK. Kur bëhet një pagesë e parashikuar, kontraktori duhet të paraqesë një deklaratë me situacionin e muajit tek drejtuesi i projektit ku deklaron se plani sipas grafikut është përmbushur. Komunikata gjithashtu duhet të shprehë vlerën e punës së egzekutuar duke hequr shumën e grumbulluar të verifikuar më parë, si dhe shumën e pagesës paraprake të papaguar dhe çdo shumë të mbajtur në pritje të korigjimit të një defekti.

29.4 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë Punimet e egzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.

29.5 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa e periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga drejtuesi i projektit.

29.6 Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

Neni 30: Vonesa në Bërjen e Pagesës



30.1 Shperblimi per demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit te vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përçindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bere llogaritja e tyre.

30.2 Kamata ligjore paguhet pa qene i detyruar kreditori (kontraktori) te provoje ndonje dem. Nëse kreditori (kontraktori) provon se ka pesuar nje dem me te madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor) duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.

Neni 31: Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

31.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 32: Forca Madhore

32.1 Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit te kontrates, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

32.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

32.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Blerësin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 33: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

33.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.



A handwritten signature in black ink, consisting of several loops and a long horizontal stroke at the end.

33.2 Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

33.3 Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

33.4 Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

33.5 Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

Neni 34: Dëmet e Likuidueshme për Vonësën në Mbarimin e Punimeve

34.1 Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

- a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 35: Negociatat dhe Amendamentet

35.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit.



35.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.

35.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 36: Ndryshimi i Porosisë

36.1 Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegociimit dhe amendimit pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

36.2 Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuar në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit original të kontratës.

36.3 Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- b) Korrigjime në materiale
- c) Korrigjime në sasi

36.4 Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materializojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshjes.

36.5 Ndryshimi i porosisë nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk formalizohet sipas kërkesave të Nenit 35 të ketyre kushteve të përgjithshme.

Neni 37: Preventivi për Njesi ose në Total

37.1 Kontrata do të përfshijë një Preventiv në Total nëse është një kontratë me shumë totale ose një Preventiv për Njesi nëse është një kontratë me çmim njësie. Nëse është një kontratë me çmim njësie, Preventivi



per Njesi do të përmbajë volumet e zerave te ndërtimit, instalimin, testimin dhe komisionet që bëhen nga kontraktori.

37.2 Preventivi per Njesi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në Preventivin ne Njesi për secilin ze punimesh.

Neni 38: Mbarimi dhe Marrja Përsipër e Ndertimeve

38.1 Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe drejtuesi i projektit do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.

38.2 Nëse drejtuesi i projektit zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japi udhëzime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zerat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.

38.3 Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në Punime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.

Neni 39: Ndërprerja për Mosplotësim

39.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

39.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

39.3 Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim te kushteve te saj

Neni 40: Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

40.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.

40.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.



Handwritten signature and illegible text.

Neni 41: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

- 41.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.
- 41.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.
- 41.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuar dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeshme të Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 42: Nënkontraktimi

- 42.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë.
- 42.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacinin që provon aftësinë e nën-kontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.
- 42.3 Cdo nënkontraktor duhet të ketë të drejtë të marre pjese në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direktë tek nënkontraktori për punët që do të kryejë
- 42.4 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nënkontraktorit.

Neni 43: Transferimi i të Drejtave

- 43.1 Kontraktori nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 44: Sigurimi i Kontrates

- 44.1 Brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për fitimin e kontratës, kontraktori duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e pranueshme siç specifikohet në



kontratë. Deshtimi për të dhene sigurimin e kontrates në formën dhe në shumën e kërkuar brenda 30 ditëve do të rezultojë në anullimin e kontratës dhe humbjen e sigurimit të Ofertës të kontraktorit.

44.2 Shuma e sigurimit te kontrates duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktori në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

44.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

Neni 45: Baza Ligjore

45.1 Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 46: Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

46.1 Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

46.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.


Neni 47: Përfaqsimi i Palëve

47.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukture organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

47.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

47.3 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 48: Lajmërimet



48.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

48.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 49: Llogaritja e Afateve

Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

Kjo kontrate pasi u hartua, u lexua nga te dyja palet, te cilat i gjeten te drejta dispozitat e saj dhe e neneshkrua ate respektivisht.

Kjo kontrate u hartua ne 4 (kater) kopje origjinale ,tre prej te cilave mbahen nga Autoriteti Kontraktor , dhe nje kopje e merr Kontraktuesi.

Kontrata firmoset dhe vuloset ne cdo flete nga te dyja palet .

**AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA GJIROKASTER**




Adresa ; Sheshi i Cercizit Gjirokaster

Nr tel : 084 26 35 00


KONTRAKTUESI

JV" B-93 " sh.p.k & "BE-IS " sh.p.k



Z. Hamza ISLAMAJ

Nr tel mob: 0682035791



*Inuisti
Semi Golemi*

12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.

13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë egzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit


15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.



Neni 17: Zbulimet

17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për te vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 18: Disponimi i Kantierit

18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktori i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

19:

Neni:

Raportimi i Grafikut të Zbatimit

19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .

19.2 Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

Neni 20: Paralajmërimi në Kohë

20.1 Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

Neni 21: Kontrolli i Cilësisë

21.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.



21.2 Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

21.3 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

21.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

Neni 22: Defektet e Pakorrigjuara

22.1 Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarise koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërmbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

Neni 23: Përgjegjësitë e Autoriteti Kontraktor

23.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit të Plote, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për:

- (a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/ kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.
- (b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

Neni 24: Përgjegjësitë e kontraktorit

24.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas Nenit 23.

Neni 25: Sigurimi

25.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në Afatin e Realizimit të Plote, në shumatat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të Punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.



25.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbrisi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

25.3 Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.

Neni 26: Testimet dhe Inspektimet

26.1 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës

26.2 Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto testime dhe inspektime.

26.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë testime ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testimeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

26.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

26.5 As egzekutimi i testeve as inspektimi i Punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 27 Garancitë

27.1 Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me Punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.

